

PROGRAMI I PUNES SE DENJE PER SHQIPERINE 2008-2010

Hyrje

Objektivi parësor i ILO-s është nxitja e shanseve, për burrat dhe gratë për të patur punë të denjë dhe produktive në kushtet e lirisë, barazisë, sigurisë dhe dinjitetit njerëzor. Programet e Punës së Denjë në nivel vendi, promovojnë punën e denjë, si një komponent kyç i politikave të zhvillimit dhe njëkohësisht, si një objektiv politik kombëtar të qeverive dhe partnerëve socialë. Ky program frymëzohet nga programet ndërkombëtare të zhvillimit, si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe Programi “Një OKB” në Shqipëri, dhe bazohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të Shqipërisë. Ai merr gjithashtu në konsideratë prioritetet e partnerëve të ILO-s, të shprehura në konsultimet e mbajtura me ta. Programi përshkruan në mënyrë të detajuar politikën, strategjitë dhe rezultatet që nevojiten për të arritur progres drejt punës së denjë për të gjithë. Ky dokument përshkruan planifikimin strategjik të aktiviteteve të bashkëpunimit të ILO-s me Shqipërinë për periudhën kohore 2008-2010. Si një reflektim i vlerësimit të partnerëve dhe të ILO-s mbi bashkëpunimin në të shkuarën (2006-07), programi synon të sigurojë bashkëveprim më të ngushtë dhe koherencë më të madhe të mbështetjes së ILO-s për Shqipërinë dhe, duke kontribuar në arritjen e ndikimit dhe rezultateve të qëndrueshme.

Ky program është hartuar nëpërmjet një procesi me natyrë pjesëmarrëse, me përfshirjen e partnerëve trepalësh. Programi i Punës së Denjë (DWCP) përbëhet nga një pjesë rrëfyese që nënvizon kontekstin, mësimet e nxjerra dhe strategjinë e ndërhyrjeve dhe një model logjik, i cili paraqet në mënyrë të detajuar ndërhyrjet.

I. Situata aktuale e parë nën perspektivën e Punës së Denjë

Gjatë dekadës së fundit Shqipëria ka bërë një progres të konsiderueshëm përsa i përket zhvillimit të saj social, ekonomik dhe politik. Megjithatë ajo vazhdon të mbetet midis vendeve të varfra të Europës dhe të përballet me një sërë sfidash të rëndësishme. Me të ardhura kombëtare për frymë përafërsisht 2,960 dollarë dhe një popullsi prej rreth 3,1 milionë banorë, Shqipëria renditet si një vend me ekonomi

me të ardhura më të ulëta se mesatare. Shqipëria është një nga vendet Evropiane me popullsi të re, pasi 46% e qytetarëve të saj janë të moshës nën 25 vjec.¹

Mbas hapave mbrapa të viteve 1997-1998, vendi arriti stabilitet makroekonomik në fillim të viteve 2000, shoqëruar vit mbas viti me një rritje ekonomike mesatare të nivelit prej 5%. Progres është shënuar në luftën kundër varfërisë, me një rënie në një periudhë 3 vjeçare prej 7% të numrit të personave që jetojnë nën nivelin e varfërisë (nga 25.4 në 2002 në 18.5 për qind në 2005)². Ky fakt përbën padyshim një hap të madh drejt përmbushjes së Objektivit të Zhvillimit për Mijëvjeçarin-1, i cili për Shqipërinë, synon uljen e nivelit të varfërisë në 13% deri më 2015. Gjithsesi, këto shifra të larta rritjeje nuk korrespondojnë me krijimin e më shumë vende pune.

Të dhënat mbi treguesit kryesorë të tregut të punës vazhdojnë të mbeten të pasigurta, pasi Shqipëria nuk ka bërë ende analiza të tregut të punës të bazuara në Vëzhgimin e Forcave të Punës.³Niveli i përgjithshëm i papunësisë së regjistruar në fund të vitit 2007 ishte 13.18 për qind⁴. Krahasuar me meshkujt, femrat kanë një pjesëmarrje shumë më të ulët në forcat e punës (në 2006 shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës në Shqipëri ishte 56.5 për qind - 66.6% meshkuj dhe 45.9% femra).⁵ Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar niveli i papunësisë të të rinjve ka qenë vazhdimisht më i lartë se ai i të rriturve. Në vitin 2005 të rinjtë kishin një nivel papunësie të shkallës 12.8 për qind (14.4 për qind meshkuj të rinj dhe 11 për qind femra të reja), krahasuar me një nivel 6.9 për qind të popullsisë në moshë pune. Perspektivat e punësimit për moshat e reja janë të vakëta. Niveli i punësimit të të rinjve në nivelin e 31.9 për qind është tejet i ulët.⁶ Shkalla e punësimit të femrave të reja është pesë për qind më e ulët se ajo e meshkujve të rinj (respektivisht 28.6 dhe 33.5 për qind). Të dhënat mbi punësimin e të rinjve tregojnë se shumë të rinj që jetojnë në zona rurale merren me bujqësi, ose si të vetëpunësuar ose duke kontribuar si anëtarë familjeje. Femrat e reja kanë mundësi të dyfishtë për të qenë joaktive dhe për të marrë pjesë më pak se djemtë në arsim.

Një nga çështjet më të rëndësishme që ushtron një ndikim negativ në ekonominë shqiptare është fenomeni i shumëpërhapur i ekonomisë informale. Një ekonomi e

1 Mosha mesatare e popullsisë shqiptare është 31.7 vjeç. Shih: ILO, Analiza e tregut të punës së të rinjve në Shqipëri (Në botim).

2 Banka Botërore, Përmbledhje për Shqipërinë 2007

3 Ka vlerë të përmendet se treguesit e tregut të punës së Shqipërisë të llogaritur në bazë të të dhënave nga regjistrat administrative ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga treguesit e llogaritur nga të dhënat e vëzhgimeve me bazë familjen (p.sh. Vëzhgimi i Matjes së Stadartit të Jetesës-LSMS).

4 INSTAT (Bilanci i forcave të punës, Tremujori i IV 2007)

5 INSTAT – Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri 2006, Tiranë, 2007.

6 Përpunimi është bazuar në Vëzhgimin e Matjes së Stadartit të Jetesës për 2005 (LSMS).

lartë informale mund të shkaktojë humbje të ardhurash si pasojë e evazionit fiskal, shtrembërime të tregut të punës, fshehje të të dhënave të vërteta të papunësisë dhe inkurajim të konkurrencën së pandershme. Tipare të zakonshme të punës në ekonominë informale janë mungesa e kontratës së punës, lejes vjetore të paguar dhe lejes së paguar për arsye shëndetësore, si dhe përfitimeve të tjera të sigurimeve shoqërore. Ekonomia informale passjell dëme serioze për individët, ndërmarrjet dhe shoqërinë në përgjithësi. Në Shqipëri ekonomia informale vlerësohet se kontribuon në rreth një të tretën e prodhimit të përgjithshëm bruto (PPB). Rreth 55 % e punëtorëve në sektorin jo-bujqësor punojnë në punë me produktivitet të ulët në ekonominë informale.⁷ Vlerësimet janë më të larta për punëtorët e bujqësisë, ku pjesa më e madhe e të cilëve janë punëtorë të vetëpunësuar për llogari të tyre, gjysma e të cilëve janë të varfër. Rreth 27 % e punëtorëve të sektorit jo-bujqësor janë punëtorë me pagesë në ekonominë informale, veçanërisht në sektorin e ndërtimit, dhe 28 % janë ose të vetëpunësuar ose merren me punë të papaguar.⁸ Punëtorët e rinj në moshë janë të mbi-përfaqësuar në ekonominë informale. Mundësia e të qenit punëtor informal lidhet në mënyrë të rëndësishme me të qenit i ri, mashkull dhe me arritje të ulëta arsimore.⁹ Në vitin 2005, numri i të rinjve të punësuar në informalitet vlerësohej të ishte rreth 70 % e numrit total të të punësuarve në moshë të re. Lëvizjet midis statuseve të punësimit janë të ulëta. Në 2002 vetëm 15 për qind e të papunëve dhe 10 % e personave inaktive kishin mundur të gjenin punë në ekonominë formale dy vjet më vonë, ndërsa 38 % e punëkërkuesve kishte gjetur punë në ekonominë informale, dhe rreth gjysma e gjithë punëtorëve informalë vazhdonin dy vjet më vonë të ishin në ekonominë informale.¹⁰

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka hasur nivele të larta migrimi, të brendshëm dhe të jashtëm. Vlerësohet se rreth 40 % e popullsisë në moshë pune punon jashtë vendit. Këto nivele të larta migracioni kanë gjeneruar mundësi dhe vështirësi për familjet shqiptare, dhe veçanërisht për gratë. Migrimi për vite me rradhë ka qenë një strategji e mundimshme e nxitur nga kushtet jocilësore të punës, pagat e ulëta, papunësia dhe varfëria. Të dhënat mbi varfërinë demonstrojnë se kategoritë e popullsisë që rrezikojnë më shumë përsa i përket varfërisë janë të papunët, më pak të arsimuarit, anëtarët e familjeve të mëdha dhe personat që jetojnë në zona rurale dhe merren me bujqësi për llogari të tyre. Çuditërisht, në krahasim me meshkujt, femrat në krye të familjeve nuk paraqesin rrezikshmëri më të lartë për

⁷ Republika e Shqipërisë, Strategjia për Përfshirjen Sociale, Nëntor 2006

⁸ Republika e Shqipërisë, Strategjia për Përfshirjen Sociale 2007-2013, Nëntor 2006 Draft.

⁹ Vlerësime numerike bazuar në LSMS 2005. Shih edhe: ILO, *Analiza e tregut të punës së të rinjve në Shqipëri (Në botim)*.

¹⁰ Banka Botërore, Shqipëria: *Vlerësimi i tregut të punës*, Washington D.C. 2006

të rënë në varfëri. Kjo ndodh kryesisht, si pasojë e faktit se në familjet e tyre ka emigrantë, të cilët kontribuojnë nëpërmjet remitancave.

Në Tetor 2007, qeveria e Shqipërisë hartoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën kohore 2007-2013, e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave në Mars të këtij viti. SKZHI synon i) arritjen e zhvillimit të shpejtë, të balancuar dhe të vazhdueshëm ekonomik, social dhe njerëzor, ii) forcimin dhe konsolidimin e shtetit demokratik, iii) vendosjen e shtetit të së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit, dhe iv) integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Kjo strategji përcakton politika me prioritet të lartë duke i dhënë një rol më të madh në ekonomi të rinjve.¹¹ Prioritetet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për periudhën 2007-2013 pasqyrohen në Strategjitë e Punësimit dhe Formimit Profesional, Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, të miratuara në vitin 2007, sikurse dhe në Strategjinë Kombëtare për Migracionin që është miratuar në vitin 2004. Objektivat e Strategjisë për Punësimin dhe Formimin Profesional përqendrohen në promovimin e një politike aktive punësimi nëpërmjet ngritjes së një sistemi modern shërbimesh punësimi (8 nga 12 objektivat), zhvillimin e një politike aktive punësimi, forcimin e sistemit të trajnimit dhe formimit profesional, reduktimin e punësimit informal, përmirësimin e kushteve të punës dhe promovimin e dialogut social.¹² Kjo politikë aktive punësimi mbështetet edhe nga Strategjia mbi Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, ndërkohë që Strategjia për Përfshirjen Sociale tregon kujdes të veçantë për masat për uljen e vulnerabilitetit të punëtorëve informalë.

Shqipëria është një nga tetë (8) vendet pilot të programit “Një OKB”. Gjatë vitit të shkuar agjensitë e ndryshme rezidente ose jo-rezidente të Kombeve të Bashkuara kanë punuar bashkarisht në mënyrë që Kombet e Bashkuara të operojnë si “Një”. Ato hartuan Programin “Një OKB” si dhe planin përkatës të punës. ILO ka marrë pjesë plotësisht në këtë iniciativë. Mandati i saj dhe Axhenda e Punës së Denjë reflektohen në Programin aktual “Një OKB” që mbulon periudhën kohore 2007-2010. Ajo ka udhëhequr gjithashtu hartimin e një prej programeve të përbashkëta më të mëdha që rezultoi në miratimin e Dokumentit të Programit të Përbashkët mbi punësimin e të rinjve dhe migrimin. Nëpërmjet strukturës së saj unike tripalëshe, ILO ka kontribuar në programin “Një OKB”, duke i dhënë rëndësi çështjeve që përfshihen në mandatin e partnerëve të saj trepalësh. Në këtë aspekt, DWCP mbështet partnerët trepalësh të marrin pjesë në mënyrë më efektive në politikat

¹² Shih Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, *Strategjia Sektorale mbi Punësimin dhe Formimin Profesional (2007-2013)*, Tiranë, 2007

publike dhe vendim-marrje, në përmirësimin e strukturave qeverisëse dhe në iniciativa që synojnë reduktimin e pabarazive rajonale.

Në kuadrin e Programit “Një OKB”, ILO po mbështet Shqipërinë në procesin e vendosjes së standarteve bashkëkohore të punës, duke këshilluar ratifikimin e standarteve ndërkombëtare të punës dhe zbatimin e tyre nëpërmjet ligjeve dhe praktikës kombëtare. Qeveria e Shqipërisë është duke u marrë aktualisht me ratifikimin e Konventës mbi Politikën e Punësimit (Nr.122), 1964. Ratifikimi i Konventës 122 do të kompletojë listën e Konventave Themelore dhe Thelbësore të ratifikuara tashmë nga qeveria e Shqipërisë.

Hartimi i DWCP aktual ka marrë gjithashtu në konsideratë Strategjinë e Asistencës për Shqipërinë të Bankës Botërore (CAS) për periudhën 2006-2009, e cila përfshin dy prioritete kryesore, konkretisht i) nxitjen e rritjes ekonomike nëpërmjet mbështetjes për zhvillimin e sektorit privat, dhe ii) përmirësimin e shpërndarjes së shërbimeve publike, veçanërisht në fushën sociale.

Programi i Punës së Denjë përmban një qëllim afatgjatë, zvogëlimin e ekonomisë informale, sikurse është rënë dakort dhe zbatuar nga qeveria në konsultim me partnerët socialë, që në përfundim do t'i shërbejë krijimit të një mjedisi të ndershëm dhe të shëndetshëm për zhvillimin e ekonomisë private, duke promovuar në këtë mënyrë rritjen ekonomike. DWCP synon gjithashtu të forcojë kapacitetin e institucioneve shtetërore dhe partnerëve socialë për përmirësimin e administrimit të tregut të punës. Ky qëllim përputhet plotësisht me prioritetin e dytë të CAS 2006-2009 për Shqipërinë të Bankës Botërore.

Dialogu social në nivel kombëtar sikurse dhe në nivel dege apo lokal do jetë gjithashtu një nga çështjet prioritare për të cilat do të tregohet kujdes. Këshilli Kombëtar i Punës (KKP), i ngritur më 1996 për të shërbyer si një forum për konsultimet trepalëshe midis qeverisë dhe partnerëve socialë ka ndeshur gjatë viteve 2002-2005 në disa vështirësi. Sidoqoftë, sipas qeverisë, që prej vitit 2006, ai filloi të zhvillojë takime më të rregullta dhe të diskutojë çështje të m]një rëndësie të veçantë, si strategjitë e punësimit, masat e sigurimeve shoqërore, shanset e barabarta dhe jo diskriminimin në tregun e punës. Shtatë ministra të qeverisë marrin pjesë në sesionet e tij duke përfshirë Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrin e Financave, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Çështja e kriterëve të përfaqësimit të partnerëve socialë ka nevojë për rishikim pasi komplikon bashkëpunimin ndërmjet tyre në kuadër të KKP. Një tjetër çështje për të cilën duhet të tregohet vëmendje është fakti se, me gjithë përpjekjet e bëra në të shkuarën, deri tani në Shqipëri nuk ka patur ndonjë konsensus mbi arritjen e një Marrëveshjeje të Përgjithshme. Partnerët socialë theksojnë se dialogu social trepalësh duhet të shkojë përtej konsultimeve duke arritur rezultate konkrete në lidhje me problemet kryesore me të cilat ndeshet vendi sikurse janë ekonomia informale, ulja e varfërisë dhe nxitja e punësimit. Riorganizmi i KKP i planifikuar për vitin 2009 ofron një mundësi unike për përmirësimin e funksionimit dhe efikasitetit të dialogut social trepalësh në mënyrë që të trajtohen në mënyrë efektive problemet ekonomike dhe sociale të lartpërmendura.

Aktualisht, as sindikatat dhe as organizatat e punëdhënësve nuk luajnë rolin efikas të cilin mund të luanin, si në nivel kombëtar ashtu dhe rajonal. Ato janë të fragmentarizuara si pasojë e mungesës së kriterëve të qarta të përfaqësimit, çka pasjell përkeqësim të bashkëpunimit të tyre të brendshëm dhe mungesën e vazhdueshme të aftësisë për të kuptuar dhe për t'u përfshirë në larmishmërinë e çështjeve që nevojitet të trajtohen.

Pensionet kanë humbur në mënyrë të konsiderueshme vlerën e tyre si pasojë e inflacionit të shpejtë në të shkuarën. Niveli i ulët i pensioneve rriti varfërinë e moshave të vjetra dhe rrjedhimisht të përfutësve të asistencës sociale. Financimi i skemës së pensioneve paraqet probleme. Aktualisht, si pasojë e kontributit jo të mjaftueshëm të të ardhurave, rreth 25% e pensioneve të qytetit dhe 70% e pensioneve të fshatit subvencionohen nga Shteti. Në mënyrë që të ofrohen përfitime të përshtatshme dhe të sigurohet qëndrueshmëria afatgjatë e skemës, reforma e pensioneve është një çështje që kërkon vëmendje urgjente.

Siguria dhe shëndeti në punë (SSHP) është një shqetësim i zakonshëm për të gjithë partnerët trepalësh. Megjithatë nuk disponohen të dhëna të sakta mbi aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, situata e sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri është larg të qenit perfekte. Në fillim të 2008 ndodhën aksidente serioze (p.sh. shpërthimi në Gërdec) me pasojë disa dhjetëra viktima, një pjesë e konsiderueshme e të cilave në sektorin e ndërtimit. Punëtorët kanë njohuri të pakta në lidhje me SSHP, veçanërisht ata që punojnë në sektorin bujqësor rural ose në ekonominë informale. Qeveria kërkoj asistencën e ILO-s dhe aktualisht është duke punuar për hartimin e një Ligji të ri mbi SSHP dhe një Strategjie shoqëruese për zbatimin e tij.

Kapacitetet e Shërbimit Kombëtar të Punës dhe institucionet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë duhet të forcohen dhe të transformohen në një sistem të integruar, me fushë aktiviteti dhe autoritet më të gjerë dhe të thellë. Për zbatimin e ligjit, është i rëndësishëm hartimi i një strategjie kombëtare mbi SSHP nga partnerët trepalësh.

Eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve është një tjetër shqetësim i programit të përbashkët të bashkëpunimit ILO-Shqipëri. Sipas Institutit Shqiptar të Statistikave, 32 % e fëmijëve të moshës 6 deri 17 vjeç, punojnë. Format kryesore më të këqija të punës së fëmijëve në Shqipëri janë fëmijët që punojnë në rrugë, trafikimi i fëmijëve, fëmijë të përfshirë në aktivitete të jashtëligjshme, fëmijë të punësuar në sektorin formal dhe fëmijët e punësuar në sektorin bujqësor. Shkaqet kryesore për të cilat punojnë fëmijët lidhen me varfërinë, papunësinë e prindërve ose migrimin e tyre, ambjentin e përçarë familjar, me arsye që kanë të bëjnë me arsimimin, si ndjekja e ulët e shkollës, mungesa e shkollave afër qendrave të tyre të banimit, përjashtimi nga shkolla, rezultatet e ulta në shkollë dhe mospëlqimi i shkollës.

Fenomeni i punës së fëmijëve dhe trafikimi i tyre do të vazhdojë të ketë edhe për breza pasardhës, një ndikim të rëndësishëm në Shqipëri në lidhje me vazhdimësinë e ciklit të varfërisë përsa kohë nuk ndërmerret një përqasje e fokusuar për zhdukjen e tij. Për këtë arsye, strategjia e ILO-s në vend, do të vazhdojë të funksionojë bazuar në një kombinim të ndërhyrjeve të politikave të rangut të lartë të kombinuara me aktivitete shërbimesh të rangut të ulët në nivel komuniteti për të pilotuar modelet e ndërhyrjes.

Programi i punës së denjë për Shqipërinë 2008-2010 është rezultat i diskutimeve të gjera me partnerët lokalë që filloi me vlerësimin e Programit të mëparshëm të Punës së Denjë (2006-2007) dhe konkludoi me përcaktimin e përmbajtjes së programit të ardhshëm me autoritetet shtetërore dhe përfaqësuesit e organizatave të partnerëve socialë. Ky proces i jep programit të ardhshëm një karakter kombëtar, faktor ky vendimtar në arritjen e rezultateve dhe objektivave të përcaktuara bashkarisht.

II. Mësime të nxjerra nga bashkëpunimi i mëparshëm

Në fund të 2007, ILO ndërmori një analizë vlerësimi me natyrë pjesëmarrëse (Shqyrtim i Programit Dyvjeçar Kombëtar - BCPR). Ky vlerësim drejtohej nga një ekspert i pavarur dhe kishte si qëllim vlerësimin e ecurisë në arritjen e rezultateve të

pritura dhe identifikimin e mësimëve të marra, me qëllim zhvillimin e Programit të ri të Punës së Denjë (DWCP).

Analiza konkludoi se, përgjithësisht mjedisi për ndërhyrjet e ILO-s është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, si pasojë e kuadrit ligjor të qëndrueshëm dhe të favorshëm, angazhimeve të mëdha kontraktuale të qeverisë ndaj BE-së që rrjedhin nga MSA-ja, axhendave ndërkombëtare të OKB-së, si Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin (MDG) dhe Korniza e Asistencës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDAF), si dhe angazhimeve të partnerëve të ILO-s në vend. Qeveria dhe partnerët socialë vlerësuan pozitivisht ndihmën teknike të ofruar nga ILO gjatë periudhës 2006-2007, e cila përfshin të katër shtyllat e punës së denjë, konkretisht: nxitja e punësimit, dialogu social, mbrojtja sociale dhe të drejtat themelore në punë. Sipas këndvështrimit të tyre, projektet e ILO-s kanë provuar se janë të mirëkonceptuar, të shëndetshëm dhe efektiv nga pikëpamja metodologjike dhe teknike. Bazuar në arritjet e Programit të mëparshëm të Punës së Denjë, partnerët e ILO-s dhe partnerët e tjerë kryesorë në vend shprehën vullnetin e tyre dhe angazhimin e sigurtë për bashkëpunim të mëtejshëm me ILO-n gjatë implementimit të ciklit të ardhshëm të Programit të Punës së Denjë. Është vlerësuar së tepërmi fleksibiliteti dhe përgjegjësia e ILO-s në përshtatjen e prioritetëve ndaj nevojave të partnerëve të saj.

ILO ka luajtur një rol udhëheqës në krijimin e një mjedisi stimulues për nxitjen e punësimit, përmes realizimit të të drejtave themelore në punë, nxitjes së dialogut social dhe avancimit të mbrojtjes sociale. Sidoqoftë, më shumë përpjekje duhet të bëhen në mënyrë që të merren në konsideratë aftësitë përthithëse të partnerëve socialë. Raporti identifikoi gjithashtu nevojën e fokusimit të më shumë aktiviteteve në nivel rajonal/lokal.

Shkalla e përthithjes së rezultateve varet shpesh nga burimet njerëzore dhe financiare që disponohen nga institucionet kombëtare dhe organizatat partnere. Kapaciteti përthithës (politik dhe financiar) i organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve do të vëzhgohet me kujdes gjatë implementimit. Kështu, duhet të vazhdojë ngritja e kapaciteteve të partnerëve për të drejtuar në mënyrë efektive institucionet dhe organizatat e tyre. Gjatë procesit të shqyrtimit partnerët përsëritën nevojën për forcimin e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës (KKP).

Më tej, partnerët shprehën nevojën për informim të rregullt përsa i përket zhvillimeve të arritura në implementimin e Programit. Paralelisht, duhet të përmirësohet përgjegjësia e partnerëve. Mekanizmat aktualë të komunikimit dhe të

shkëmbimit të informacioneve, nuk konsiderohen të mjaftueshëm në mënyrë që të rritet shpërndarja për të gjithë përfaqësuesit në nivel vendi (partnerët lokalë dhe rajonalë), dhe për këtë arsye, Qeveria dhe ILO duhet të bëjnë më shumë përpjekje në këtë drejtim (p.sh. përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si posta elektronike).

III. Fushat prioritare të bashkëpunimit

Programi i Punës së Denjë synon të mbështesë integrimin e Shqipërisë në strukturat (p.sh. Bashkimin European) dhe programet (p.sh. MDG) ndërkombëtare. Shumë prej rezultateve të tij janë në të njëjtën linjë me Programin “Një OKB”, Strategjinë e Asistencës së Bankës Botërore dhe Marrëveshjen Europiane të Stabilizim-Asociimit (BE-MSA). Pra, ky program është në të njëjtën linjë me Programin “Një OKB” të Kombeve të Bashkuara duke siguruar koherencë politikash në mbështetjen që i jepet vendit dhe një zhvillim më efikas. Programi synon të ndihmojë vendin në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA në lidhje me sistemet e sigurimeve shoqërore, të drejtat themelore në punë, kushtet e denja të punës dhe shanset e barabarta, si dhe lëvizjen e lirë të punëtorëve. Kjo gjë mund të arrihet nëpërmjet mbështetjes së strategjive sektoriale dhe të ndërthurua, të cilat përfshihen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013). Kjo përjasje synon të garantojë koherencë të politikave të këshillimit që ofrohen nga organizatat ndërkombëtare dhe, në të njëjtën kohë, të ofrojë mbështetje dhe asistencë teknike në fusha të identifikuara si prioritare nga partnerët.

Brenda temës kryesore “Punë e denjë për të gjithë”, ILO do të përqendrohet në tri prioritete programatike në Shqipëri për periudhën 2008-2010, të cilët duhet të shihen si objektiva afatgjatë:

- I. Rritja e kapacitetit të institucioneve shtetërore dhe partnerëve socialë me qëllim përmirësimin e administrimit së tregut të punës;
- II. Mbështetja e masave të marra nga Qeveria për reduktimin e ekonomisë informale;
- III. Përmirësimi i mbulimit të sistemit të mbrojtjes sociale.

ILO ka një avantazh krahasues në zhvillimin e programeve, planeve dhe bashkëpunimit teknik për arritjen e objektivave të lartpërmendura. Më konkretisht, Sekretariati i ILO-s ka një ekspëriencë shumëvjeçare dhe ekspertizë teknike në fushat e standarteve të punës, nxitjes së punësimit, sigurimeve shoqërore dhe

dialogut social. Gjithashtu ILO ka implementuar një sërë programesh në Europën Qendore dhe Lindore duke përbushur pritshmëritë e donatërove dhe qeverive të këtyre vendeve.

Prioriteti 1: Rritja e kapacitetit të institucioneve shtetërore dhe partnerëve socialë për të përmirësuar administrimin e tregut të punës

Nevoja për institucione më të forta, të cilët të jenë në gjendje të zbatojnë procesin e reformave që lidhen me MSA-në me BE dhe SKZHI, ndërthuret me gjithë prioritetet e zhvillimit. Ndërhyrjet e ILO-s për rritjen e kapacitetit do të kenë për qëllim aktorët e dialogut social dhe institucionet e dialogut social, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MOLSAEO), Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Inspektoratin e Punës si dhe partnerët socialë.

Rezultati 1: Përmirësohet funksionimi i Këshillit Kombëtar të Punës (KKP) me një mandat më të gjerë për të përfshirë dhe çështje ekonomike dhe sociale. (ALB101).

Në Shqipëri ekziston një konsensus i përgjithshëm ndërmjet aktorëve trepalësh mbi nevojën e konsolidimit të funksionimit, strukturës dhe përbërjes së KKP-së, në mënyrë që të shndërrohet në një forum më të fortë dhe të qëndrueshëm për konsultimet trepalëshe lidhur me politikat kombëtare ekonomike dhe sociale. Problemet kryesore në veprimtarinë si dhe vendimarrjen e KKP-së janë përbërja dhe përfaqësueshmëria.

Dialogu social dypalësh në nivel dege, territori dhe ndërmarrjeje duhet të forcohet.

ILO ka mbështetur KKP-në gjatë programit të Punës së Denjë 2006-07 dhe do të vazhdojë të ofrojë asistencë teknike gjithëpërfshirëse për Këshillin Kombëtar të Punës (KKP) me synim përmirësimin e funksionimit si dhe përbushjen e detyrave të tij, nëpërmjet:

- a) rishikimit të rregullores dhe përbërjes, duke përfshirë dhe këndvështrimin gjinor
- b) forcimit të sekretariatit të tij
- c) trajnimit të anëtarëve të tij në lidhje me procesin e dialogut social dhe strategjitë/ekspoze të proceseve përparimtare të dialogut social në vendet e BE-së.

Organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve do t'u ofrohet asistencë teknike për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive dhe efikase në dialogun social dypalësh dhe trepalësh në të gjitha nivelet. Puna me partnerët socialë do të intensifikohet më shumë krahasuar me vitet e mëparshme.

Do të hartohet një program trajnimi për promovimin e praktikave të dialogut social dypalësh në nivel dege, territori dhe ndërmarrjeje, duke përmirësuar aftësitë negociuese të partnerëve socialë dhe forcuar mekanizmat për parandalimin e konflikteve dhe zgjidhjeve.

Treguesit e rezultateve:

Partnerët nënshkruajnë një marrëveshje trepalëshe që miraton projektin e rregullores së re të KKP-së. Është rënë dakort dhe janë vendosur kriteret e përfaqësimit.

KKP-ja punon në mënyrë më efikase: mblidhet rregullisht, trajton çështje të rëndësishme sikurse është ekonomia informale, ka një përbërje të re duke përfshirë dhe këndvështrimin gjinor, i cili reflekton më mirë situatën aktuale të marrëdhënieve industriale.

Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve zhvillojnë dhe paraqesin për diskutim në KKP dhe në forume të tjera propozime politikash.

Marrëveshje të tjera kolektive nënshkruhen në nivel dege, territori dhe ndërmarrjeje.

Rezultati 2: Janë formuluar dhe zbatuar politika dhe programe punësimit me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore për të trajtuar objektivat e efikasitetit dhe barazisë të cilat janë në të njëjtën linjë me parashikimet e stadarteve ndërkombëtare të punës mbi politikën e punësimit dhe shërbimet e punësimit (C122 dhe C88) (ALB102)

Ky rezultat bazohet në punën e Qeverisë shqiptare që u ndërmorr në dyvjeçarin 2006-07 me mbështetjen e ILO-s. Në vijim të angazhimit të marrë nga Ministri e Punës të vendeve të Europës Jug-Lindore në Bukuresht në vitin 2003, Shqipëria filloi rishikimin e politikës së saj të punësimit nga ILO dhe Këshilli i Europës. Rekomandimet e Rishikimit të Politikës së Punësimit të Shqipërisë (CREP) u miratuan nga një Konferencë Kombëtare Trepalëshe në vitin 2005. Bazuar në rekomandimet prioritare të CREP, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, zhvilloi Strategjinë e parë mbi Punësimin dhe Formimin Profesional.

Programi aktual i Punës së Denjë synon të mbështesë qeverinë në hartimin dhe zbatimin e një politike aktive punësimi. Kjo do të realizohet nëpërmjet ratifikimit të standarteve ndërkombëtare të punës mbi politikat e punësimit dhe shërbimet e punësimit dhe transpozimit të parimeve që përmbajnë këto Konventa në legjislacionin kombëtar. Qeveria, në konsultim me partnerët socialë do të miratojë një ligj të ri bashkëkohor mbi nxitjen e punësimit i cili do të trajtojë objektivat e efikasitetit dhe barazisë. Paralelisht, ILO do të mbështesë implementimin e 8 nga 12 objektivat e strategjisë së punësimit dhe formimit profesional, si dhe zhvillimin e politikës së punësimit të të rinjve dhe planin respektiv kombëtar të veprimit. Asistenca teknike do ti ofrohet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të zhvilluar njohuritë dhe instrumentat për përcaktimin dhe shpërndarjen e shërbimeve të punësimit si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal (ngritja e institucioneve) me programe aktive të tregut të punës nëpërmjet trajnimit dhe shërbimeve të kontraktuara (asistencë e drejtpërdrejtë). Ngritja e institucioneve dhe asistenca e drejtpërdrejtë do të ndihmojë Strategjinë e sipërpërmendur, si dhe atë mbi përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe migrimin.

Ky rezultat do të rezultojë në: i) kapacitet më të madh institucional për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e një politike aktive punësimi me ndjeshmëri për çështjet gjinore, ii) zhvillim të shërbimeve të integruara të punësimit dhe trajnimit, iii) hartim dhe zbatim i programeve aktive të tregut të punës me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore dhe që kanë në qendër të vëmendjes persona të papunë që rrezikojnë përjashtimin nga tregu i punës. Kjo mund të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, partnerëve socialë, ILO-s, iniciativave të finacuara nga BE mbi shërbimet e punësimit dhe inspektimit në punë, IOM dhe partnerëve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Treguesit e rezultateve:

Janë ratifikuar Konventat mbi Politikën e Punësimit dhe Shërbimet e Punësimit.

Është miratuar dhe zbatohet ligji për nxitjen e punësimit.

Është hartuar dhe zbatuar politika e punësimit të të rinjve dhe plani kombëtar i veprimit.

Është vlerësuar performanca e shërbimeve publike të punësimit dhe janë miratuar masat për modernizimin e funksioneve thelbësore të një Shërbimi Punësimi Publik.

SHKP i ofron grupeve që rrezikojnë përjashtimin nga tregu i punës, politika aktive të tregut të punës me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore duke përfshirë shërbime punësimi.

Është ngritur sistemi për trajnimin e kontraktuar dhe shërbime të tjera punësimi, si dhe programe aktive të financuara për tregun e punës.

Rezultati 3: Administrata e Punës, duke përfshirë edhe Inspektoratin e Punës zbatojnë në mënyrë efikase Standartet Ndërkombëtare të Punës nëpërmjet legjislacionin kombëtar (ALB103):

Shqipëria ka ratifikuar 42 konventa ndërkombëtare të punës. Sipas organeve mbikëqyrëse të ILO-s disa nga këto standarte nuk zbatohen në mënyrë efikase si në ligj ashtu dhe në praktikë. Për të zgjidhur këtë problem, ILO do të rrisë kapacitetin e Administratës së Punës, duke përfshirë dhe inspektoratin e punës si dhe partnerët socialë, për zbatimin e standarteve ndërkombëtare të punës, si dhe përsa i përket procedurës së raportimit, nëpërmjet shërbimeve të trajnimit dhe këshillimit. Gjithashtu do të organizojë aktivitete për rritjen e kapacitetit të nëpunësve të Ministrisë së Punës duke përfshirë dhe inspektorët e punës, dhe partnerët socialë, për formulimin e ligjeve në fushën sociale dhe të punës dhe garantimin e zbatimit me efikasitet të tyre. Ndonëse ky ishte një prioritet edhe i ciklit të shkuar të DWCP, ILO nuk arriti të sigurojë fonde për një program më të madh. Është e nevojshme që të vazhdojnë përpjekjet e ILO-s dhe të partnerëve kombëtarë për të siguruar fonde për arritjen e këtij rezultati. Asistencë teknike do të ofrohet për forcimin e inspektoratit të punës në lidhje me zbatimin e standarteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Treguesit e rezultateve:

Është përmirësuar cilësia e raportimeve mbi konventat e ratifikuara dhe përgjigjet ndaj komenteve të autoriteteve mbikëqyrëse të depozituara pranë ILO-s (matur në bazë të vlerësimit pozitiv të CEACR)

Janë përmirësuar të dhënat e vendit për Depozitimet (neni 19 i Kushtetutës së ILO)

Ligjet e punës janë zbatuar më me efikasitet dhe ky përmirësim është reflektuar në raportin vjetor të inspektimit në punë në 2009.

Rezultati 4: Rritje e vlerës së organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve përsa i përket anëtarëve ekzistues dhe potencialë nëpërmjet parashikimit të shërbimeve të reja dhe më të mira (ALB104):

Në mënyrë që të luajnë një rol më efikas në mbledhjet e KKP-së, organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve duhet të jenë përfaqësuese të partnerëve të tyre-punëmarrësve dhe punëdhënësve. Për këtë arsye këto organizata duhet të rriten në

numër. Mënyra më efikase për të arritur këtë është ofrimi i shërbimeve të reja ose më të mira.

Rritja e kapacitetit të sindikatave lidhet me forcimin e dialogut social sektorial dhe me ristrukturimin e degës (seminare trajnimi, asistencë teknike, mbledhje pune). Rritja e kapacitetit të Organizatave të Punëdhënësve do të përqendrohet tek trajnimet për krijimin e aftësive për të identifikuar, zhvilluar dhe shpërndarë shërbime të reja për anëtarët, dhe në këtë mënyrë këto Organizata do të tërheqin më shumë anëtarë dhe do të bëhen më përfaqësuese, si dhe trajnimet për hartimin e momerandumeve për të kontribuar më mirë në zhvillimin e politikave që kanë ndikim tek punëdhënësit.

Treguesit e rezultateve:

Për sindikatat: shërbime të përmirësuara; anëtarësi më e madhe, marrëveshje efikase në nivel dege, marrëveshje që përfshijnë çështje të barazisë gjinore.

Për organizatat e punëdhënësve: shërbime të reja, anëtarësi më të madhe, përfshirë dhe rritje të numrit të femrave sipërmarrëse.

Priority 2: Masa për zvogëlimin e ekonomisë informale për të cilat është rënë dakort dhe zbatohen nga Qeveria në konsultim me partnerët socialë

Problemi i ekonomisë informale do të trajtohet në disa aspekte. ILO do të ofrojë asistencë për forcimin e institucioneve, zhvillimin e politikave dhe rritjen e kapacitetit të aktorëve trepalësh p.sh, duke zhvilluar dhe zbatuar politika aktive për tregun e punës, duke zhvilluar politika punësimit për të rinjtë, duke forcuar dhe aktivizuar organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat, dhe duke krijuar një ambjent më miqësor për biznesin.

Rezultati 1: Janë ngritur mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional që përfshijnë edhe partnerët socialë, për të zbatuar masat e kalimit nga ekonomia informale në ekonominë formale (ALB126):

ILO do të mbështesë partnerët trepalësh në zhvillimin e një plani veprimi për të trajtuar problemin e ekonomisë informale, duke u përqendruar në sektorin e ndërtimit, nëpërmjet trajnimeve për rritjen e kapacitetit të tyre në përjasjet e ndryshme të çështjes së ekonomisë informale, për krijimin e një forumi trepalësh në sektorin e ndërtimit për luftën kundër ekonomisë informale dhe për lëshimin e një fushate mediatike për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me shtrirjen e këtij

problemi, pasojat e tij sociale dhe ekonomike si dhe nevojën për zgjidhjen në tërësi të tij.

Kjo përbën një fushë të re pune të cilën ILO po e trajton me një përjasje të integruar. Informaliteti në sektorin e ndërtimit do të jetë dhe tematika e Konferencës Kombëtare të Punës, një nga aktivitetet vjetore trepalëshe më të rëndësishme që organizohet nga ILO në bashkëpunim me Qeverinë dhe Partnerët Socialë.

Treguesit e rezultateve:

Është kryer diagnostikimi i shtrirjes, shkaqeve dhe pasojave të ekonomisë informale në sektorin e ndërtimit nëpërmjet një studimi të një eksperti kombëtar me përfshirjen edhe të partnerëve trepalësh.

Eshte ngritur një grup pune trepalësh i cili bën propozime për një plan veprimi sektorial për trajtimin e problemit të ekonomisë informale.

Plani i veprimit është miratuar në një forum trepalësh dhe i nënshtrohet për miratim autoriteteve përkatëse publike.

Plani i veprimit fillon të zbatohet.

Rezultati 2: Janë formuluar politikat dhe programet për punësimin e të rinjve për të përmirësuar menazhimin e migrimit dhe për të zvogëluar punësimin informal (ALB127)

Ky rezultat fokusohet në një fushë të re pune, aty ku ILO do të bashkëpunojë në partneritet me katër agjensi të tjera të Kombeve të Bashkuara si pjesë e nismës “Një OKB”. Ai trajton mbi-përfaqësimin e punëtorëve në moshë të re në ekonominë informale, e cila është një strategji e përkohshme për shumë njerëz të rinj për të përballuar varfërinë para se të kenë një rast për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës dhe punës, nëpërmjet migrimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ai synon përmirësimin e shanseve për punë të denjë të femrave dhe meshkujve të rinj nëpërmjet kordinimit të strategjive të zhvillimit për të rinjtë, punësimin dhe migracionin. Rezultatet e pritshme direkte përfshijnë: i) kapacitet të përmirësuar të qeverisë shqiptare për të monitoruar punësimin e të rinjve dhe treguesit e migracionit; ii) një kuadër partneriteti për punësimin e të rinjve midis sektorit publik dhe atij privat; iii) njohuri më të mira të politikave të integruara dhe masave për zhdukjen e ekonomisë informale dhe impaktit të tyre në migrim; iv) një sistem kordinimi për paktet sociale të punësimit të të rinjve në nivel lokal. Programe përparimtare për punësimin e të rinjve do të pilotohen në rajonet e Shkodrës dhe Kukësit. Këto programme do të synojnë të nën-punësuarit dhe punëtorët informalë në moshë të re të cilët janë të ekspozuar ndaj migrimit dhe merren kryesisht me bujqësi.

Ky rezultat do të kontribuojë në arritjen e dy prej 5 rezultateve të Programit “Një OKB” (p.sh. qeverisje më transparente dhe e përgjegjshme dhe zhvillimi rajonal) dhe në promovimin e partneritetit për punë të denjë dhe produktive (MDG8) nëpërmjet veprimit të përbashkët të ILO, IOM, UNDP, UNICEF dhe MOLSAEO, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Punëve të Jashtme, autoriteteve lokale dhe partnerëve socialë. Në mënyrë më specifike, ai do të prodhojë rezultatin 1.1.4 të Programit “Një OKB” mbi menaxhimin e migrimit i cili do të përqendrohet në minimizimin e migrimit të të rinjve nëpërmjet një kordinimi më të mirë të politikave të punësimit dhe migrimit. Gjithashtu, rezultati i DWCP do të kontribuojë në vënieën në jetë të rezulttit 4.1.4 të Programit “Një OKB” i cili trajton pabarazitë rajonale nëpërmjet promovimit të zhvillimit ekonomik dhe punësimit të denjë.¹³

Treguesit e rezultateve:

Janë vendosur treguesit e tregut të punës mbi punësimin e të rinjve dhe migracionin.

Politikat e migrimit, krijimit të punësimit dhe zhvillimit të të rinjve të SKZHI janë në të njëjtën linjë me strategjitë e tregut të punës.

Është vendosur kuadri për partneritetin sektor public - sektor privat për punësimin e të rinjve.

Programe përparimtare dhe me ndjeshmëri për çështjet gjinore që synojnë punëtorët informalë në moshë të re dhe të rinj të tjerë në disavantazh, që janë të ekspozuar drejt migrimit janë pilotuar në dy rajone.

Rezultati 3: Krijohet një ambjent më miqësor për biznesin dhe merren masat që synojnë rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së punës për të inkurajuar ndërmarjet dhe punëtorët të futen në ekonominë formale. (ALB128)

Si pjesë e punës në ekonominë informale, vëzhgimi që do të ndërmerret në sektorin e ndërtimit do të identifikojë pengesat praktike për kalimin në ekonominë formale për punëdhënësit.

Rritja e kapacitetit të organizatave të punëdhënësve do të lidhet me identifikimin e masave për të mbështetur anëtarët potenciale të Organizatave të Punëdhënësve për të kaluar nga ekonomia informale në atë formale.

Rritja e kapacitetit të sindikatave do të fokusohet në organizimin e ekonomisë informale.

¹³ Rezultati 4.1.4 të Programit Një OKB synon të zgjerojë zhvillimin ekonomik në tre rajone pilote, duke përfshirë Shkodrën dhe Kukësin, nëpërmjet iniciativave lokale ekonomike duke u përqendruar në krijimin e punësimit, gjenerimit të të ardhurave dhe produktivitetit të fermerëve.

Treguesit e rezultateve:

Do të përmirësohet kapaciteti i partnerëve socialë për diskutime dhe hartime politikash për të luftuar ekonominë informale.

Organizatat e Punëdhënësve kanë zhvilluar planin e veprimit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen gjatë kalimit në ekonominë formale.

Janë zhvilluar strategjitë për rritjen e anëtarëve të sindikatave edhe nga rradhët e ekonomisë informale.

Priority 3: Përmirësimi i cilësisë së sistemit të mbrojtjes shoqërore

Sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore, që është ngritur në Maj të vitit 1993 tashmë po përballlet me sfida të rëndësishme në lidhje me vlerën e përfitimeve, nivelit të mbulimit dhe qëndrueshmërisë financiare. E konceptuar si një system *Pay-As-You-Go* (PAYG), skema e sigurimeve shoqërore ka patur probleme financiare qysh prej vitit të parë të zbatimit të saj, duke patur parasysh që pothuajse një e katërta e popullsisë në moshë pune, emigroi kryesisht në vendet fqinje, duke ulur në këtë mënyrë burimet e të ardhurave për fondin e sigurimeve shoqërore. Në anën tjetër, zhvillimi i shpejtë i ekonomisë (rritja mesatare e ekonomisë për shumë vjet ka qenë rreth 6%) në kushtet e mungesës së zbatimit me efikasitet të ligjit, çoi në rritje të konsiderueshme të ekonomisë informale. Kjo situatë do të thotë më pak kontribute në fondin e sigurimeve shoqërore, ndërkohë që një numër shumë i madh personash dhe familjet e tyre janë të përjashtuar nga mbulimi. Me rritjen e vazhdueshme të çmimeve në vend, rritjet vjetore të përfitimeve të sigurimeve shoqërore mezi mbulojnë në rastin më të mirë inflacionin dhe rritjen e çmimeve. Situata e përgjithshme e sistemit të sigurimeve shoqërore ka nevojë të reformojë skemën dhe Banka Botërore ka marrë udhëheqjen në këtë proces. Qysh prej fillimit të vitit 2008 ka filluar një përpjekje zyrtare e përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Bankën Botërore. Janë konsultuar partnerët në lidhje me nevojën e reformave, ndërkohë që eksperiencia e vendeve të tjera është vënë në dispozicion të kësaj audience.

Ndonëse siguria dhe shëndeti në punë është një shqetësim i zakonshëm për partnerët trepalësh, situata e sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri vuan nga mungesa e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi i ulët si nga ana e punëdhënësve, ashtu edhe nga ana e punëmarrësve.

Në trajtimin e çështjes së mbrojtjes sociale në formën e saj më të gjerë, DWCP në Shqipëri do të fokusohet në problemin e administrimit të sigurimeve shoqërore. Ai

do të këshillojë partnerët e ILO-s në hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmarrin gjatë reformimit të skemës dhe do të ofrojë trajnim për rritjen e kapacitetit profesional të partnerëve. DWCP do të trajtojë gjithashtu edhe zhvillimin e një plani kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe do të punojë për parandalimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet asistencës teknike dhe rritjes së kapacitetit për partnerët e ILO-s.

Rezultati 1: Administrimi i sigurimeve shoqërore përmirësohet falë mekanizmave trepalësh (ALB151)

Do të forcohet kapaciteti i bordit trepalësh të institucioneve të sigurimeve shoqërore nëpërmjet një sërë aktiviteteve trajnuese si dhe shërbimesh të tjera këshilluese.

Treguesit e rezultateve:

Bordi trepalësh i institucioneve të sigurimeve shoqërore përdor udhëzime dhe trajnime mbi administrimin e sigurimeve shoqërore.

Punëtorët dhe punëdhënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në debatin e reformës së pensioneve.

Rezultati 2: Është zhvilluar Strategjia Kombëtare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe një kulturë parandaluese (ALB152)

ILO do të ofrojë asistencë teknike për përmirësimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë, veçanërisht legjislacionit. ILO do të ngrejë kapacitetin e partnerëve trepalësh për të zhvilluar dhe zbatuar Strategjinë Kombëtare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

ILO do të ofrojë asistencë teknike për nëpunësit shtetërorë, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve si hapa të mëtejshëm të Konventës 187 (2006).

Treguesit e rezultateve:

Asistenca teknike e ILO-s është përdorur për hartimin dhe zhvillimin e një sistemi kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ekspertët e sigurisë dhe shëndetit në punë të Qeverisë, sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve përdorin instrumentat e ILO-s.

Rezultati 3: Frenimi i Trafikimit të Qenive Njerëzore dhe Formave të tjera më të këqija të punës së fëmijëve në vend (ALB153)

ILO do të vazhdojë të ndihmojë vendin për përfshirjen e eliminimit të formave më të këqija të punës së fëmijëve në strategjitë kombëtare; të ngrejë kapacitete; të ndihmojë në zbatimin e legjislacionit; të ndërgjegjësojë; të ndërtojë bazë dijesh me orientim tek aktivitetet e shërbimeve në nivel komunitar me shërbime të drejtpërdrejta të ofruara për fëmijët dhe familjet e tyre nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Mbështetja e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (CLMS), identifikimi I fëmijëve, vlerësimi I rreziqeve për ta, regjistrimi I fëmijëve në mënyrë që t@u ofrohen alternativa të shëndetshme në tre qytete: Tiranë, Korçë dhe Berat nëpërmjet Komiteteve të Aksionit Lokal dhe katër Grupeve Multi-Disiplinare.
- Përgatitja e një Raporti Kombëtar mbi Punën e Fëmijëve në Shqipëri duke përfshirë dhe një Plan Veprimi Kombëtar kundër punës së fëmijëve.
- Mbështetja e përjasjeve multi-disiplinare në lidhje me shërbimet e drejtpërdrejta për fëmijët që punojnë dhe fëmijët në rrezik nëpërmjet ofrimit të arsimit jo-formal; arsimit formal, aktiviteteve krijuese, formimit profesional, ushqimit.
- Zhvillimi i aktiviteteve me arsimtarë të dalluar në tre qendra rinore bazuar në Manualin për Aftësitë Jetike dhe paketën SCREAM (Duke mbështetur të drejtat e fëmijëve nëpërmjet Arsimit, Artit dhe Medias) Supporting children' rights through Education, Arts and Media).

Treguesit e rezultateve:

Përgatitja e Raportit Kombëtar Vjetor të Shqipërisë mbi punën e fëmijëve me të dhëna të gjeneruara nga CLMS.

Funksionimi i mire i CLMS mundëson detifikimin e fëmijëve, vlerësimin e rreziqeve të tyre dhe regjistrimin e tyre në sistemet e references të ngritur në Tiranë, Korçë dhe Berat.

Përfshirje dhe kapacitet më i madh i Partnerëve Socialë në çështje që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve duke përfshirë dhe parandalimin e trafikimit.

IV. Menaxhimi dhe zbatimi

Programi i bashkëpunimit do të menaxhohet nëpërmjet një rrjeti të ngritur midis Zyrës Nën-Rajonale të ILO-s në Budapest, Kordinatorit Kombëtar në Tiranë, Zyrës Rajonale EUROPE dhe njësisë teknike në zyrën qendrore në Gjenevë. Kordinatori

Kombëtar do të luajë rol koordinues së bashku me Zyrën Nën-Rajonale të ILO-s në Budapest. ILO do të vazhdojë bashkëpunimin e saj me partnerë të tjerë në vend, sikurse janë agjensitë e tjera të Kombeve të Bashkuara nën ombrellën e Programit Një OKB, dhe Delegacioni i Komisionit European.

Objektivat e programit do të ndiqen nëpërmjet projekteve të bashkëpunimit teknik, misioneve këshilluese dhe seminareve trajnuese për përhapjen e informacioneve dhe ngritjen e kapacitetit. Për zbatimin e këtij programi do të përdoren burime financiare jashtë-buxhetore, financime të përbashkëta nëpërmjet Programit “Një OKB”, si edhe burime të buxhetit të rregullt të ILO-s. Rrjeti i sipërpërmendur i ILO-s do të vazhdojë të kërkojë burime të mëtejshme për monitorimin e rezultateve të arritura, duke marrë parasysh shqetësimet prioritare të partnerëve. Qeveria dhe partnerët socialë do të ofrojnë ekspertët e tyre respektivë dhe ambiente pune, si dhe do të japin sipas rastit mbështetje logjistike. Ata janë të angazhuar të zbatojnë hapat e mëtejshëm të nevojshëm për të arritur rezultatet e pritshme. Këto do të shpjegohen më hollësisht në Planin e Punës së Programit të Punës së Denjë (*shih Aneksin*).

V. Monitorimi i zbatimit dhe masat vlerësuese

Zbatimi i programit të Punës së Denjë do të rishikohet rregullisht me partnerët nëpërmjet ngritjes së një Bordi Trepalësh për Programin e Punës së Denjë. Përzgjedhja e anëtarëve të Bordit do të bëhet gjatë ceremonisë së nënshkrimit të Programit të Punës së Denjë.

Detyrë e Bordit është promovimi i objektivave të Programit të Punës së Denjë dhe monitorimi i zbatimit të Programit të Punës së Denjë, garantimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë palëve të përfshira si dhe përmbushja e angazhimeve të tyre në mënyrë që të arrihen rezultatet për të cilat është rënë dakort bashkarisht.

Bordi do të takohet dy herë në vit për të vlerësuar arritjet e shënuara. Ky eveniment do të përdoret gjithashtu për rishikimin me Kordinatorin Kombëtar të planit të punës për Programin e Punës së Denjë. Nëse shihet e nevojshme, do të bëhen ndryshime në mënyrë që të përshtatet me kushtet e ndryshuara, me arritjen e rezultateve të pritura, përfshirë këtu edhe ripërcaktimin e programeve të disa prej aktiviteteve në vend. Drejtori i Zyrës Nënrajonale bashkë me partnerët do të vlerësojë arritjet e programit në Shqipëri në fund të çdo dyvjeçari.

